



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

|   |                       |
|---|-----------------------|
| REPublika e Kosovës<br>REPublika Kosova<br>QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETAREVE<br>CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA |                       |
| Sh. U. <u>02</u>  | Nr. Br. <u>21.399</u> |
| Nr. i faq. <u>4</u>   | Data: <u>04/09</u>    |
| Br. str. <u>KAMENICËJA</u>  | Datum: <u>2024</u>    |

Komuna e Kamenicës  
Opstina Kamenica  
Kamenica Municipality



Mbështetur në nenin:12 paragrafi 1 të Rregullores së Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës nr.04/2017, mbi Financimin Publik të OJQ-ve , si dhe Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurën e Ndarjes së Subvencioneve , me nr. 31251 – 09/2022,  
Zyra e Kryetarit shpallë:

### THIRRJE PUBLIKE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PUBLIKE PËR ORGANIZIMIN E FESTIVALIT “KAMENICA SUMMER FEST” 2024

**Zyra e Kryetarit-** i fton organizatat e regjistruara si **OJQ** (sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata jo-qeveritare në Republikën e Kosovës) dhe Individët që kanë përvojë në organizimin e aktiviteteve që janë relevante me festivalin, që të aplikojnë për mbështetje financiare me projektet-idetë e tyre.

Afati për aplikim për Subvencione në kategorinë subvencione për organizimin e festivalit Kamenica Summer Fest është i hapur deri më **15.07.2024**.

Kategoritë për Aplikim:

#### 1. OJQ-të, në përputhje me këtë ftesë publike mund të aplikojnë me projektet/programet e tyre për këto aktivitete:

##### • Aktivitete:

- Kamping
- Organizimi i lojërave të ndryshme
- Ekskursionë në natyrë dhe monumente kulturore
- Turne në sporte të ndryshme
- Gara të vrapimit dhe maratonë
- Gara në volejball, futboll, streetball
- Gara të çiklizmit

- Koncerte dhe performanca muzikore
- Shfaqje teatrale dhe stand-up comedy
- Ekspozita
- Karnavalet dhe paradat e kostumeve
- Promovimi dhe mbulimi mediatik i festivalit
- Projekte filmike dhe dokumentare
- Konkurs për fotografi dhe videografi
- Transmetime live të aktiviteteve të festivalit
- Dhe aktivitete të ngjashme

## **2. Kriteret e përgjithshme për OJQ-të:**

Për t'u kualifikuar për mbështetje financiare publike, aplikuesit duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme minimale të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- 1. Certifikatën e regjistrimit të OJQ-së (obligative)**
- 2. Certifikatën e numrit fiskal (obligative)**
- 3. Të ketë dorëzuar projekt-propozimin të plotësuar në formatin e aplikacionit sipas kërkesave të thirrjes publike (obligative)**
- 4. Të ketë dorëzuar propozim buxhetin në formatin sipas kërkesës së thirrjes dhe të plotësuar në tërësi (obligative)**
- 5. Të dorëzojë deklaratat e partneritetit në raste kur propozohet implementimi i projekteve në partneritet .**
- 6. Të dorëzohet CV e menaxherit të projektit.**
- 7. Aktiviteti doemos të realizohet në Komunën e Kamenicës**

**Kriteret e përgjithshme minimale për INDIVIDËT të përcaktuara me dispozitat në vijim:**

- Aktiviteti doemos të realizohet në Komunën e Kamenicës
- Në rast se individi ka përfituar më parë mbështetje financiare publike, duhet të ketë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare;

- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikantit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikantit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.
- Individët nuk kanë të drejtë të aplikojnë me më shumë se 1 projekt-propozim në këtë thirrje publike.

### **Periudha e zbatimit të projekt-propozimit:**

Projekt-propozimet përfituese në këtë thirrje publike duhet të zbatohen në tërësi deri më 15.08.2024.

### **3. Kriteret e vlerësimit:**

Me rastin e vlerësimit të projekt-propozimeve, Komisioni do të vlerësojë me sa vijon:


1. Të posedojë OJQ-ja, respektivisht, kapacitete profesionale për të kryer aktivitetet e planifikuara të projektit/programit (a kanë aftësitë e duhura dhe aftësitë për zbatimin e projektit, si dhe njohuri në lidhje me çështjet që trajtohen në këtë ftesë)?
2. Të posedojë kapacitete të menaxhimit të mjaftueshme OJQ-ja (duke përfshirë personelin, pajisjet për të udhëhequr me projektin)?
3. Sa relevant është projekt-propozimi për qëllimet dhe fushat të ftesës publike (a ndërlidhet projekti me aktivitetet e parapara me politikat e fushës, të cilat i mbulon ftesa publike)?
4. A janë objektivat e projektit/programit të përcaktuara në mënyrë të qartë dhe realisht të arritshme?
5. A janë aktivitetet e projektit / programit të qarta, të arsyeshme, të kuptueshme dhe të zbatueshme?
6. A janë kostot e projektit/programit reale në lidhje me rezultatet specifike dhe kohëzgjatjen e pritshme të projektit?

Vlera totale financiare e planifikuar e thirrjes publike është: **20000** euro,

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për një projekt është: **550**

euro, ndërsa shuma maksimale për një projekt është: **6000** euro.

***OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti një (1) projekt në kuadër të kësaj ftese publike. Periudha e realizimit të projektit është nga 20 korriku deri më 15 gusht.***



Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë të cilat së bashku me Udhëzimet për aplikantë janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes <https://kk.rks-gov.net/kamenicë>

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen personalisht në adresën e më poshtme:

**KOMUNA E KAMENICËS**  
**Rr. "Skënderbeu"**  
**Objekti i Administratës Komunale**  
**Qendra për Shërbim me Qytetarë**

**Procesi i pranimit hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve përfshinë,**

- **Vlerësimi i aplikacioneve;**
- **Kontraktimi;**
- **Dhënia e fondeve;**
- **Koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave.**

Trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për të aplikuarit e thirrjes publike.

Do të konsiderohen për mbështetje vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen te zyrtari përgjegjës **Lidiona Marovca**, në mënyrë elektronike duke dërguar e-mail në adresën: [Lidiona.marovca@rks-gov.net](mailto:Lidiona.marovca@rks-gov.net), ose në numrin kontaktues +383(0) 45 903 396 gjatë orarit të punës 08:00-16:00h (e hënë – e premte).

